



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/01-22030/25
Kaçanik, 08.09.2025

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VIII (tetë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 08 shtator 2025. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve, me fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF prej 7 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 7 anëtarët-të gjithë: Kemal Murseli, Kadri Krivenjeva, Rustem Zenuni, Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Ardita Rrahmani, Edona Luzha. Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i komunës -Sabedin Vishi, Valdrin Dogani-DBF, Suhad Dullovi- DBPZHR, Arian Teneqja-DSHPE.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Procesmbajtës: Mavije Murseli- Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, pastaj e hapi mbledhjen e VIII (tetë) të rregullt të KPF-së për vitin 2025, data 08.09.2025, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Propozim Vendimi për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2026 dhe vlerësimet për vitet 2027-2028;
3. Propozim Vendimi për miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt (2025-2030).

Lidhur me rendin e propozuar të punës, e hapi diskutim:

znj. Kadrije Lika-Troni: Deshiroj të shtoj në rendin e ditës një diskutim lidhur me djegien e varrezave të qytetit, një akt i shëmtuar që ka ndodhur disa ditë më parë. Qytetarët kanë shprehur ankesa dhe dëshirojnë të dinë se kush e ka kryer këtë akt. A jeni të informuar si qeverisje lokale mbi këtë ngjarje?

Gjithashtu, kërkoj të sqarohet përgjegjësia e drejtorit të Shërbimeve Publike: kujt i takon pastrimi i varrezave dhe të na raportohet në detaje, nëse kjo është kompetencë e Bashkisë Islame apo bëhet në bazë të vullnetarizmit të qytetarëve. Po ashtu, a ka arritur Komuna të identifikojë personat përgjegjës për këtë akt, duke pasur parasysh se në varreza ka edhe eshtra të familjarëve? Për shembull, edhe familjarë të ngushtë të mi kanë eshtra të djegura aty.

Kryesuesi i Kuvendit: Sa i përket kësaj që ngrite më parë, mendoj se është mirë që Kuvendi ta trajtojë si çështje, ashtu si kemi ngritur kërkesat e tjera. Sipas meje, komunat nuk kanë përgjegjësi dhe nuk di që kanë pasur ndonjë përgjegjësi për pastrimin e varrezave. Ne i pastrojmë ato vullnetarisht vetë, po flas për përvojën time personale. Nuk e di çfarë kanë thënë të tjerët në këtë drejtim, por nuk ka ndonjë lloj përgjegjësie të caktuar. Nëse dikush e ka marrë atë përgjegjësi, është individuale. Në rastet që po përmenden, djegia e eshtrave përbën vepër penale.

znj. Kadrije Lika-Troni: Unë, si anëtare e Kuvendit, kam bërë thirrje publike që të angazhohen zjarrfikësit dhe institucionet kompetente. Përmes zjarrfikësve a është bërë e ditur se kush janë personat: a janë individë, a bëjnë pjesë në një kompani, apo kush janë ata.

Kryesuesi i Kuvendit: E kuptoj shqetësimin, por në raste të tilla Komuna nuk shkon të intervistojë dhe të kërkojë se kush ka vënë zjarrin. Për këto raste merren zjarrfikësit dhe policia, që janë organet kompetente dhe bëjnë koordinimin përkatës. Nuk e di çfarë roli duhet të ketë Komuna në këtë debat, sepse ajo nuk ka kompetencë direkte në këtë drejtim. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se Komuna nuk duhet të ketë interes për këtë çështje. Por sa i përket veprës që ka ndodhur, mendoj se përgjigjja duhet të merret nga organet kompetente; policia ka përgatitur një raport dhe zjarrfikësit kanë ndërmarrë veprimet e tyre. Meqë nuk ka kush diçka tjetër, atëherë Rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 3 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikëve sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së VII (shtatë) të rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) për vitin 2025 të datës 24.07.2025 / Lënda: 01Nr. 60/01-16744/25.

2. Propozim Vendimi për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2026 dhe vlerësimet për vitet 2027-2028;

Kryesuesi i Kuvendit: Për shkak të afateve të shkurtra të fushatës zgjedhore, është e nevojshme që ne si Kuvend të veprojmë me procedura të përshpejtuara. Besoj se ekzekutivi ka shterruar debatet publike, ndërsa ne si Kuvend kemi pasur një afat më të shkurtër. Megjithatë, me datën 10 shtator 2025 do të kemi një formalitet për debat publik, dhe është mirë që ju, si anëtarë të KPF-së, të merrni pjesë. Për sqarime të nevojshme, fjalën e ka drejtori i Buxhetit dhe Financave.

z. Valdin Dogani: Buxheti i Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2026 është në shumën prej 13,399,753.00 €, ndërsa për vitet 2027 dhe 2028, vlerësimet e parashikuara janë si vijon: për vitin fiskal 2027 në shumën prej 14,070,440.00 € dhe për vitin fiskal 2028 në shumën prej 14,757,058.00 €.

Në strukturën e të hyrave buxhetore për vitin fiskal 2026, mjetet nga grantet qeveritare janë në shumën prej 12,334,620.00 €, që përbëjnë 92.05% të totalit, ndërsa të hyrat vetanake komunale arrijnë shumën prej 1,065,133.00 €, me pjesëmarrje prej 7.95% në strukturën e përgjithshme të buxhetit.

Shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin fiskal 2026 parashikohen të jenë: Shpenzime operative në shumën prej 10,192,442.00 €, Investime kapitale në shumën prej 3,207,311.00 €. Shpenzimet buxhetore për vitin 2026, sipas kategorive ekonomike, janë parashikuar me këtë ndarje, në përputhje të plotë me Qarkoren Buxhetore 2026/02, të datës 21.08.2025, të nxjerrë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT): Paga dhe shtesa: 7,883,305.00 € (58.83%), Mallra dhe shërbime: 1,469,980.00 € (10.97%), Shpenzime komunale: 225,000.00 € (1.68%), Subvencione dhe transfere: 614,157.00 € (4.58%), Investime kapitale: 3,207,311.00 € (23.94%).

z. Agim Mani: Nuk e di çfarë kuptimi ka debati publik pasi, pasi ta marrim miratimin për të dërguar buxhetin në Kuvend, ne e përcjellim si i tillë. Mund të ndodhë që nesër të ndryshohet diçka, ose gjatë diskutimit publik të bëhen ndryshime, por nëse e dini edhe ju, kjo zakonisht nuk ndodh. Duke qenë se, siç po thuhet, është më shumë një formalitet, debati publik është i panevojshëm.

Kryesuesi i Kuvendit: Unë tregova se problemi nuk është ynë; ky është problem i atyre që i kanë caktuar zgjedhjet lokale. Për shkak se duhet të merret parasysh ky fakt, nuk është përgjegjësi jonë. Ne vetëm duhet të zbatojmë rregullat që i kanë përcaktuar të tjerët. Kur thashë se është formal, nuk do të thotë që buxheti që ne e përcjellim për Kuvend është miratuar.

Buxheti merr miratimin përfundimtar nga Kuvendi. Ne e kemi paraqitur para Kuvendit, dhe gjatë këtij procesi çështjet mund të ndryshohen nëse ka kërkesa për ndryshime. Kuvendi është ai që jep fjalën përfundimtare. Ju ftoj që të merrni pjesë në debat dhe të diskutoni aty; nëse ka diçka shumë të rëndësishme, mund të ndryshohet. Procedura është e përsheptuar: ligji jep 14 ditë, por ka raste kur thirret 8 ditë para, si është rasti ynë. Ne jemi në rregull me atë që kemi bërë; kërkesat i kemi ngritur një ditë para Kuvendit dhe nesër shkojmë në Kuvend me dokumentacionin e gatshëm. Nëse del nevoja për ndryshime nga debati publik, kjo është çështje tjetër dhe varet nga vullneti i votës në Kuvend. Pra, ky aspekt nuk është problem, sepse nuk do të thotë se buxheti është miratuar; ai vetëm propozohet për diskutim dhe miratim, dhe vendimin përfundimtar e jep Kuvendi.

z. Valdrin Dogani: Përveç dëgjimit të KPF-së, ne kemi paraprirë edhe dëgjime buxhetore me shumë grupe të tjera, si OJQ, biznese dhe këshilla lokale. Shumë nga kërkesat e paraqitura në tabelat që kemi janë rezultat i këtyre dëgjimeve buxhetore. Jemi vonuar për arsye se qarkorja e dytë buxhetore, e cila duhej të vinte më 11 korrik, ka ardhur më 21 gusht, dhe kjo ka shtyrë të gjitha procedurat. Qarkorja e dytë buxhetore tregon kufijtë final për secilën kategori: paga, mallra, subvencione, dhe shërbime komunale. Edhe pse mund të bëhen disa ndryshime gjatë përgatitjes, kufijtë janë të përcaktuar dhe nuk mund të ndryshohen.

Kryesuesi i Kuvendit: Ju nuk jeni vonë; procedurat jemi vonuar ne. Ju deri në shtator e keni sjellë buxhetin në Kuvend dhe jeni në rregull. Por ne nuk jemi në rregull, sepse për ne afati është i ngushtë. Kuvendi duhet të ketë rreth një muaj kohë për të trajtuar këto tema para miratimit, që është deri më 30 shtator, ndërsa ne nuk mund të kalojmë datën 13 shtator për shkak se fillon fushata zgjedhore. Për këtë arsye thashë që do të ishte mirë të bëhej përgatitja më përpara. Kjo është hera e parë që nuk i mbajmë zgjedhjet në nëntor; zgjedhjet e nëntorit janë marrë parasysh për këtë çështje.

znj. Ardita Rrahmani: Më interesojnë investimet kapitale, konkretisht ato për zhvillimin ekonomik. Drejtoresha e Zhvillimit Ekonomik nuk është prezent, por ka një kod të ri që lidhet me ngritjen e infrastrukturës për turizëm. Shuma aktuale është shumë e përgjithshme: 300.000 euro, kurse për vitin e ardhshëm parashihen 50.000 euro. Ajo që më intereson është të di më konkretisht se çfarë projekti parasheh kjo shifër dhe çfarë investimesh përfshihen.

z. Valdrin Dogani: Përveç kësaj, është bërë një ndryshim teknik për shkak të kohës së shkurtër që kemi pasur.

Është ngritur projekti për infrastrukturën e turizmit përgjatë lumit Lepenc dhe në Grykën e Kaçanikut, të cilin e kemi plotësuar.

Është kod i ri, projekt i ri, dhe për vitin e ardhshëm janë paraparë 50,000 euro për investim.

Rrustem Zenuni: Kam një shqetësim lidhur me futjen e një kodi buxhetor për rrugën Semaj–Çaçkë. Edhe me ligj lejohet, pasi është rrugë ndërkomunale. Mendoj se lehtësisht mund ta realizojmë këtë projekt dhe madje mund të sigurojmë edhe një donator për ta zgjidhur problemin e banorëve.

Shqetësimi i tyre është se, nëse kjo rrugë nuk rregullohet, ata kanë gjasa të shpërngulen drejt Ferizajt. Kjo rrugë do t'ua lehtësonte shumë jetën. Mendoj se, me bashkëpunim me Komunën e Ferizajt, kjo mund të realizohet.

z. Agim Mani: Po e shpreh shqetësimin tim sa i përket investimeve kapitale. Edhe pse është rritur buxheti komunal, investimet kapitale janë ato që i prekin qytetarët më së shumti dhe, fatkeqësisht, janë duke shkuar në rënie. Këto investime duhet të trajtohen si çështje serioze dhe prioritare për t'u realizuar. Edhe pse janë të vogla, prapëseprapë, në fund të vitit, na mbesin rreth 30% pa u shpenzuar.

Për rastin e rrugës në Semaj, që e përmendi Rustemi, kam pasur rast ta shoh edhe vetë dhe banorët e kërkojnë këtë rrugë prej kohësh. Rruga nuk i ka mbi 1000 metra. Mendoj se do të duhej të ndahej një kod buxhetor me një shumë prej 50.000 euro dhe me zhavorr me shtruar do të ishte e mjaftueshme për këtë rrugë.

Sa i përket ndërtimit dhe rregullimit të hapësirës publike te Lushi, Doganaj, janë ndarë 100.000 euro. Kisha thënë që ta keni parasysh, pasi është projekt madhor që shtrihet nga Fusha e Pajtimit deri në Glloboshicë, dhe projekti ka filluar.

Për ndërtimin e trotuarit në rrugën rajonale Ahmet Kaqiku, segmenti nga restoranti Natyra deri te Fusha e Pajtimit (faza e dytë), janë ndarë vetëm 2000 euro, që do të thotë se nuk e keni planifikuar të vazhdohet në mënyrë të plotë.

Besim Ilazi: Është një gabim teknik, pasi faza e dytë përfundon këtë vit dhe menjëherë fillon faza e tretë për anën tjetër, konkretisht anën e majtë.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimi për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2026 dhe vlerësimet për vitet 2027-2028. **Ky propozim vendim, i**

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

3. Propozim Vendimi për miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt (2025-2030);

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Arian Teneqja: Për shkak të ligjshmërisë dhe disa kërkesave të MMPHI-së, plani është kthyer edhe një herë. Kanë kërkuar një plotësim për VSM. Tani plani ka ardhur përsëri dhe është kthyer për arsye të hartimit të tij si plan ndërkomunal, i përgatitur nga rajoni i Ferizajt dhe Gjilanit, nga ekspertë të GIZ-it dhe komunave të tjera. Ata kanë përmirësuar kërkesat që kishin pasur më parë.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimi për miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt (2025-2030). **Ky propozim vendim i**



Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu e konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora: 12:05. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët - 07.

Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 11.09.2025 në ora 11:00.

Procesmbajtëse
Mavije Murseli



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

